



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ac.nr.5452/18

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Halide Reka, kryetare e kolegjit, Valon Totaj dhe Arsim Hamzaj, anëtar, në çështjen juridike kontestimore të paditësit U.D., nga fshati ..., Komuna Fushë Kosovë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson S.B., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Firma Private “E...” sh.p.k në Prishtinë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson A.XH., avokat nga Gjilani, për anulim të vendimit, kthim në punë dhe kompensimin e të ardhurave personale, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.589/13, i datës 11.10.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 14.04.2022, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET pjesërisht e pabazuar ankesa e të paditurës Firma Private “E...” sh.p.k në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.589/13, i datës 11.10.2018, në pikën *I (një)*, *II (dy)* dhe pjesërisht pika IV (katër) e dispozitivit në pjesën në të cilën është detyruar e paditura Firma Private “E...” në Prishtinë, që paditësin ta kthej në vendin e mëparshëm të punës, **VËRTETOHET**.

II. APROVOHET pjesërisht e bazuar ankesa e të paditurës Firma Private “E...” sh.p.k në Prishtinë, **PRISHET** Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.589/13, i datës 11.10.2018, në pikën III (tre), pjesërisht pika IV (katër) e dispozitivit në pjesën në të cilën është detyruar e paditura që paditësit t’ia kompensoj të ardhurat personale në emër të dëmit material të shkaktuar me ndërprerje të kundërligjshme të marrëdhënies së punës për periudhën kohore nga data 21.02.2013 e gjerë me datë 20.07.2017, pagimin e kontributit pensional dhe tatimin në pagë, me kamatë prej 8 % si dhe pika V (pesë) e dispozitivit të të njëjtit aktgjykim përkitazi shpenzimet e procedurës, ashtu që në këtë pjesë çështja i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar C.nr.589/13, i datës 11.10.2018, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit U.D., nga fshati ..., Komuna Fushë Kosovë. Në pikën II të dispozitivit e ka anuluar si të kundërligjshëm vendimin e të paditurës Firma Private "E..." në Prishtinë, rr. "...", nr..., me nr. 08/2012 i datës 21.02.2013, me të cilin paditësit i është shkëputur kontrata e punës. Në pikën III ka vërtetuar se paditësit nuk i është ndërprerë marrëdhënia e punës me vendimin e cekur në pikën I të dispozitivit dhe të njëjtit i kanë takuar të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës. Në pikën IV e ka detyruar të paditurën Firma Private "E..." në Prishtinë, që paditësin ta kthej në vendin e punës dhe t'ia kompensoj të ardhurat personale në emër të dëmit material të shkaktuar me ndërprerje të kundërligjshme të marrëdhënies së punës për periudhën kohore nga 21.02.2013 e gjerë me datë 20.07.2017, si në vijim:

-Në emër të pagave të pa paguara, pagave neto shumë prej 11,772.98 €, për periudhën kohore prej datës 21.02.2013 e deri në datën e hartimit të ekspertizës me datë 20.07.2017.

-Në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës të bëjë transferim të parave në emër të paditësit shumë prej 636.00€, për të njëjtën periudhë.

-Në emër të tatimit në pagë të Administratës Tatimore të paguaj shumë prej 311.02€

-Në emër të kamatës vonesës për periudhën prej datës 01.03.2013 e deri me datë 20.07.2017 ta paguaj shumë prej 970.47 €, pra në total të paguaj shumë prej 12,720.00€, krejt këto me kamatë prej 8%, që nga data 20.07.2017 e gjerë në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit me dhunë. Në pikën V të dispozitivit e ka detyruar të paditurën që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë të përgjithshme prej 1,228.00€.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljes së dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe vendimit për shpenzimet e procedurës me propozim për Gjykatën e Apelit që aktgjykimin e ankimuar ta prishë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë ose lëndën ta kthej në rivendosje.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të LPK-së, ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është pjesërisht e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me dt. 01.03.2013, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurës për anulimin e vendimit, kthim në punë dhe kompensimin e të ardhurave dhe beneficioneve të tjera që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, me arsye sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, në seancën e shqyrtimit kryesor ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.589/13, i datës 11.10.2018, me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar gjykata ka theksuar se nga provat e administruara ka gjetur se në mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues fakti se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura në kohë të pacaktuar sipas kontratës së punës të dt. 01.07.2011, në vendin e punës punëtor sigurimi me pagë mujore prej 240 €, ku ka punuar deri me dt. 21.02.2013 dhe se me vendimin e të paditurës të dt. 21.02.2013 të njëjtit i është ndërprerë marrëdhënia e punës. Kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse ka qenë fakti që ka të bëjë me mënyrën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, më saktësisht ligjshmëria e vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Gjykata e shkallë së kishte vërtetuar faktin se e paditura me dt. 21.02.2013 paditësin gojarisht e ka lajmëruar që të mos vij në punë, paditësi me dt. 25.01.2013 i është drejtuar me kërkesë Inspektoratit të Punës për të inspektuar rastin e tij. Pastaj paditësi me dt. 12.03.2013 ka ushtruar padi në gjykatë. Inspektorati i Punës me dt. 12.03.2013 ka përpiluar raportin zyrtar, pas këtij raporti e paditura ka përpiluar vendimin për shkëputjen e kontratës së punës paditësit ku të njëjtin vendim ia ka dorëzuar paditësit me dt. 15.03.2013 në të cilin është edhe nënshkrimi i paditësit, gjë që vërtetohet se e paditura ia ka lëshuar vendimin paditësit vetëm pas inspektimit të rastit nga Inspektorati i Punës.

Ka arsyetuar se raportit zyrtar të Inspektoratit të Punës të dt. 12.03.2013 gjykata nuk ia fali besimin, ngase i njëjti nuk kishte mbështetje në provat tjera materiale që gjenden në shkresat e lëndës, pasi në shkresa të lëndës nuk gjendet asnjë provë me të cilat vërtetohet se e paditura ka zhvilluar procedurë disiplinore për të vërtetuar faktin se paditësi ka kryer shkelje disiplinore. Gjykata duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të ndërprerjes së marrëdhënies së punës ka gjetur se i njëjti është nxjerr në kundërshtim me nenin 86 par 3 të Ligjit të Punës nr.03/L-212 i dt. 01.11.2010, ligj i zbatueshëm në kohën kur paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës, në të cilin përcaktohet se “Vendimi i punëdhënësit duhet të bëhet me shkrim duke theksuar arsyetimin dhe këshillën për mjetet juridike ndaj masave të shqiptuara”, si dhe në kundërshtim me nenin 85 të po të njëjtit ligj ku është paraparë se “për shkelje të detyrave të punës, të punësuarit i shqiptohet njëra nga masat ndëshkuese si: vërejtje me gojë, vërejtje me shkrim, ulje në pozitë shqiptohen në rastet e shkeljeve të lehta të detyrave të punës, ndërsa masat ndëshkuese si suspendimi i përkohshëm dhe ndërprerja e marrëdhënies së punës shqiptohen për shkeljet e rënda të detyrave të punës në pajtim me Kontratën Kolektive, aktin e brendshëm të punëdhënësit dhe kontratën e punës, e në rastin konkret e paditura i shqiptoi paditësit masën më të rëndë disiplinore: ndërprerje e marrëdhënies së punës, e që nuk është në përputhje me as një prej akteve të përmendura, vendimi nuk ka elemente qenësore të një vendimi të rregullt, nuk është i arsyetuar dhe i mungon këshilla juridike.

Gjykata e shkallës së parë pasi kishte vërtetuar këtë gjendje faktike vendosi të aprovonte si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit duke e anuluar si të kundërligjshëm vendimin e të paditurës për shkëputjen e kontratës së punës e po ashtu ta detyroj të paditurën që paditësin ta kthej në punë duke i kompensuar pagat, kontributin pensional dhe tatimin për periudhën kontestuese. Po ashtu gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të kërkesës së paditësit për kompensimin e pagave dhe kontributeve pensionale ka gjetur se rrjedhimisht edhe kjo kërkesë është e bazuar. Në këtë kuptim në cilësinë e provës materiale ka administruar ekspertizën financiare të punuar nga M.M., me datën. 20.07.2017 me të cilën ka gjetur se sikur të punonte paditësi në periudhën nga data 21.02.2013 deri 20.07.2017 do të realizonte të ardhura personale neto shumë prej 11,772.98 €, e po ashtu llogaria e saj në trustin pensional do të rritej për shumë prej 636.00€, ndërsa tatimi në paga që duhet paguar në dobi të buxhetit të Kosovës në shumë prej 311.02 Euro. Gjykata ia fali

besimin ekspertizës së ekspertes M.M. pasi që të njëjtën e vlerësoi si profesionale dhe të argumentuar mirë.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes i është referuar dispozitës së nenit 71; nenit 86 par.3, nenit 79 dhe 55 të Ligjit të Punës 03/L-212 të dt. 01.11.2010, nenit 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 136 të LMD-së.

Vendimin mbi kamatën gjykata e mbështeti në dispozitën e nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e mbështeti në dispozitën e nenit 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë në pjesën e dispozitivit e cila me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit është vërtetuar (pika I e këtij aktgjykimi) është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit, kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së. Drejtë dhe në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike, ku gjykata e shkallës së parë edhe ka dhënë arsye të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare të cilat kanë pasur ndikim në mënyrën e vendosjes, të cilat kanë mbështetje në provat nga shkresat e lëndës dhe në ligj dhe se aktgjykimi i ankimuar rezulton të mos jetë përfshirë as me shkelje tjera sipas pretendimeve ankimore të palës ankuese.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të t'paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, ngase kjo gjykatë vlerëson se dispozitivi i aktgjykimit të atakuar në pjesën e vërtetuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kësaj pjese të kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Në lidhshmëri me këtë gjykata ka dhënë shpjegime për mënyrën se si i ka vlerësuar provat, mënyrën se si i ka kualifikuar faktet e çështjes në pajtim me normat materialo-juridike dhe si i ka zbatuar normat materialo-juridike në përputhje me gjendjen faktike, ku nga kjo rezulton se aktgjykimi i ankimuar në pjesën e vërtetuar përmban të gjitha elementet e kërkuara me dispozitën e nenit 160 të LPK-së.

Janë të paqëndrueshme pretendimet ankimore të t'paditurës për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore përkitazi me rrjedhën e procedimit të kësaj çështje nga gjykata e shkallës së parë ngase referuar shkresave të lëndës respektivisht procesverbaleve të seancave gjyqësore të mbajtura nga gjykata e shkallës së parë rezulton se gjykata e shkallës së parë procedimin e kësaj çështje e ka bërë në procedurë të rregullt gjyqësore konform dispozitave të LPK-së, e po ashtu me datën 07.11.2016 gjykata e shkallës së parë ka mbajtur seancën përgatitore në të cilën përveç palës paditëse ka prezantuar edhe përfaqësuesi i palës së paditur.

Për Gjykatën e Apelit janë të paqëndrueshme pretendimet ankimore të palës së paditur përkitazi me kërkesën për përjashtimin e gjyqtarës së çështjes nga procedimi i lëndës, ngase për një kërkesë të tillë është vendosur nga Kryetarja e Gjykatës kompetente konform dispozitës së nenit 70 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, për arsye se sipas vlerësimit të kësaj gjykate, gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat përkatësisht faktet e çështjes, mbi bazën e të cilave ka krijuar një pasqyrë të qartë, nga e cila ka rrjedhë se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar në pjesën e dispozitivit e cila me aktgjykimin e Gjykatës se Apelit është vërtetuar (pika I e këtij aktgjykimi), për arsye se:

Nga shkresat e lëndës konstatohet se: paditësi me këtu të paditurën ka lidhur marrëdhënie juridike të punës, në kohë të pacaktuar, në bazë të kontratës së punës të datës 01.07.2011. E paditura me vendimin Nr.08/2012 të datës 21.02.2013 paditësit i shkëputë kontratën e punës me arsyetimin se paditësi nuk ka respektuar rregullat e punës. Paditësi me datë 25.01.2013 i është drejtuar me kërkesë Inspektoratit të Punës për inspektimin e rastit të tij, ndërsa brenda afatit ligjor me datë 01.03.2013 ka ushtruar padi në gjykatë për realizimin e të drejtës së tij.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të t 'paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale për arsye se: me dispozitën e nenit 71 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 parashihet se: *“ 1. Punëdhënësi mund të ndërpresë kontratën e punës në kohë të pacaktuar në bazë të nenit 70, të këtij ligji në këto intervale kohore të njoftimit: 1.1. prej gjashtë (6) muaj deri në dy (2) vite punësim, tridhjetë (30) ditë kalendarike; 1.2. prej dy (2) deri në dhjetë (10) vite punësimi, dyzetepesë (45) ditë kalendarike; 1.3. mbi dhjetë (10) vite punësim, gjashtëdhjetë (60) ditë kalendarike.”*

Me dispozitën e nenit 85 të po të njëjtit ligj parashihet se: *1. Për shkeljen e detyrave të punës, të punësuarit do t'i shqiptohet njëra nga këto masa ndëshkuese: 1.1. vërejte me gojë; 1.2. vërejtje me shkrim; 1.3. ulje në pozitë; 1.4. suspendim të përkohshëm; 1.5. ndërprerje të marrëdhënies së punës. 2. Masat ndëshkuese, vërejtje me gojë, vërejtje me shkrim dhe ulje, degradim të pozitës, do të shqiptohen për shkelje të lehta të detyrave të punës në pajtim me Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit dhe Kontratën e Punës. 3. Masat ndëshkuese, suspendimi i përkohshëm dhe ndërprerja e marrëdhënies së punës, do të shqiptohen për shkelje të rënda të detyrave të punës në pajtim me Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit dhe Kontratën e Punës.”*

Dispozita e nenit 86 par. 3 e ligjit të sipërcekur ka paraparë se: *“Vendimi i punëdhënësit duhet të bëhet me shkrim duke theksuar arsyetimin dhe këshillën për mjetet juridike ndaj masave të shqiptuara”.*

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore e duke u bazuar në këtë gjendje faktike Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejt ka aplikuar të drejtën materiale e cila për qëndrimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara, bindëse faktike dhe juridike për faktet vendimtare për vendosje në këtë çështje juridike në këtë pjesë të kërkesëpadiisë dhe se drejtë ka konstatuar se në rastin konkret e paditura nuk ka rrespektuar dispozitat ligjore me rastin e shkëputjes së kontratës së punës paditësit, se vendimi për shkëputjen e kontratës së punës nuk përmban elementet qenësore dhe drejtë ka vendosur kur të njëjtin e ka anuluar si të kundërligjshëm.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit, nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkëlje në pjesën e dispozitivit e cila me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit është vërtetuar (pika I e këtij aktgjykimi), prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë në pjesën që është prishë dhe është kthyer në rigjykim sipas pikës II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, (në pikën III (tre) të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar)- me të cilën gjykata e shkallës ë parë e ka vërtetuar se paditësit nuk i është ndërprerë marrëdhënia e punës me vendimin e cekur në pikën I të dispozitivit dhe të njëjtit i kanë takuar të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës), është i përfshirë në shkëlje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) lidhur me nenin 160 .3 të LPK-së, pasi që kjo pikë e dispozitivit të aktgjykimit është e paqartë, kontradiktore me vetvete dhe me pikat tjera të dispozitivit të aktgjykimit të atakuar dhe si e tillë është e pa ekzekutueshme, e kjo paraqet shkëlje të dispozitës së nenit 160.3 të LPK-së.

Shkeljet tjera në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë në pjesën që është prishë dhe është kthyer në rigjykim sipas pikës II të dispozitivit të këtij aktgjykimi konsistojnë edhe në atë se gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike në raport me faktin nëse paditësi gjatë periudhës për të cilën ka qenë i larguar nga puna ku i janë njohur të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës prej datës 21.02.2013 e deri në ditën e nxjerrjes së ekspertizës datë 20.07.2017, a ka qenë i punësuar në ndonjë institucion tjetër, a ka realizuar të ardhura si dhe a ka paguar kontribute ndaj institucioneve shtetërore, nga të cilat do të llogaritej në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme e drejta e paditësit për kompensimin e të ardhurave personale për periudhën sa ka qenë i larguar nga puna. Kjo për faktin se referuar shkresave të lëndës rezulton se largimi nga puna ka ndodhur me datën 21.02.2013, ndërsa gjykata lidhur me lartësinë e pagave ka vendosur në vitin 2018, që i bie mbi 5 vite, e që paditësi ka mundur të punojë në ndonjë institucion tjetër përgjatë kësaj periudhe dhe kompensimi i të ardhurave për gjithë këtë periudhë pa e sqaruar rrethanën nëse paditësi ka qenë i punësuar dikund, do të ishte e padrejtë dhe paditësi do të paguhej dy herë për të njëjtën periudhë kohore.

Në të vërtetë kur gjykata vërteton se punëtorit i ka pushuar në mënyrë paligjshme marrëdhënia e punës dhe për atë shkak nuk ka realizuar të ardhura personale, duke pësuar kështu dëm, ai ka të drejtën e shpërblimit të dëmit në shumën e të ardhurave të cilat do ti kishte realizuar sikur të ishte në vend të punës. Mirëpo, me atë rast merren parasysh edhe rrethanat që kanë ndikuar që punëtori gjatë kohës sa ishte jashtë marrëdhënies së punës, eventualisht të ketë realizuar fitimet e caktuara te ndonjë organizatë tjetër, punëdhënësi privat ose te ndonjë punëdhënës tjetër, duke u ulur kështu vëllimin e dëmit të pësuar, gjë që duhet të merret parasysh me rastin e caktimit të dëmit, e çka nuk është bërë në rastin konkret.

Për pjesën e kthyer në rigjykim, gjykata e shkallës së parë udhëzohet që në ri procedurë të vërtetojë në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike ashtu që të vërtetojë faktin nëse paditësi për periudhën që kërkon kompensimin e të ardhurave personale a ka qenë në marrëdhënie pune dhe a ka realizuar të ardhura personale, nëse po në çfarë periudhe kohore dhe lartësi të pagës, e pasi të

vërtetohet ky fakt të kërkojë nga ana e ekspertës plotësimin e ekspertizës, e cila pastaj do të llogarisë saktësisht lartësinë e kompensimit për këtë periudhë kohore, nga e cila lartësi duhet zbritur fitimet e caktuara sa ishte jashtë marrëdhënies së punës të e paditura dhe tek pas sqarimit të gjithë këtyre fakteve, të merr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj për këtë çështje kontestimore.

Në lidhje me vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi sepse shpenzimet duhet të përcaktohen në mënyrë unike për të gjitha shpenzimet e pranueshme në përfundim të vendosjes meritore për të gjitha kërkesat.

Nga arsyet e paraqitura më lart e në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 paragrafi 1 pika (d) dhe (c) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.5452/18, me datë 14.04.2022

Kryetarja e kolegjit
Halide Reka, d.v